



KOMITETI SHQIPTAR I HELSINKIT

Tabela paraprake e vlerësimit të fakteve/vlerësimit nga monitorimi		Datë: 06.02.2019	Numri i seancës për këtë çështje: 1 (një)
<i>Ky monitorim u realizua në kuadër të projektit nr.2 "Për të rritur transparencën, gjithëpërfshirjen dhe përgjegjshmërinë në procesin e Vettingut" – projekt i mbështetur financiarisht nga Fondacioni për Shoqërinë e Hapur Shqipëri (OSFA) dhe zbatuar nga Komiteti Shqiptar i Helsinkit (KSHH).</i>			
<b>A. Informacioni bazë</b>			
Institucioni dhe tema:	Institucioni: Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (KPK). Objekti: Procesi për rivlerësimin kalimtar të subjektit, z. Eriol Roshi		
Emri i subjektit të rivlerësimit	z. Eriol Roshi		
Pozicioni i punës/ qyteti nëse nuk është Tirana	Gjyqtar/Kryetar në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë, Tiranë.		
A u shty seanca dhe a ishte e arsyeshme kjo shtyrje?	Nuk pati shtyrje të seancës dëgjimore dhe as shkak ligjor që ajo të shtyhej.		
A u shpall vendimi apo jo (Ju lutem paraqisni arsyet në mënyrë të përmblëdhur)	Në fund të seancës dëgjimore trupi gjyqësor u tërhoq për marrjen e vendimit dhe shtyu seancën për shpalljen e tij në datën 07.02.2019, ora 09:00.		
<b>B. Aktorët që marrin pjesë në proces/seanca</b>			
Trupa gjyqësore (emrat)	Kryesues: Genta Tafa(Bungo), Relator: Valbona Sanxhaktari, Anëtar: Lulzim Hamitaj.		
Monitoruesit ndërkombëtarë (emrat)	Përfaqësuesi i Operacionit Ndërkombëtar të Monitorimit (OMN): z. Theo Jacobs		
Mbrojtje me avokat apo mbrojtje personalisht (specifikoni)	Personalisht		
Monitoruesi/ja i/e KSHH:	Amilda Celami		
Anëtarë të tjerë të publikut të pranishëm?	Në sallën ku u zhvillua seanca dëgjimore të pranishëm ishin përfaqësues të organizatave të shoqërive civile, familjarë të subjektit të rivlerësimit, qytetarë të interesuar. Numri total i të pranishmëve varioje 10-15 persona		
Media e pranishme:	Operatorë (kameramanë) dhe gazetarë të mediave të ndryshme ishin të pranishëm. Operatorëve në përputhje me Rregulloren e KPK-së, para shqyrtimit të çështjes iu kërkua nga kryetarja e trupit gjyqësor të linin sallën.		
<b>C. A vendosi institucioni i vettingut ta bëjë vettingun për të tre kriteret apo bazuar vetëm në një apo dy prej tyre?</b>	<b>Po/Jo</b> KPK e bazoi gjykimin mbi tre kriteret (Vlerësimi i pasurisë, Kontrolli i figurës, Vlerësimi i aftësive profesionale)	<b>Nëse po, si u justifikua ai?</b>	<b>Nëse po, si ka reaguar subjekti ndaj kësaj ?</b>

D. Përmbajtja e çështjes (Vlerësimi i kritereve)	Argumenti	Kush e ka dhënë argumentin	A u diskutua? Prova? A u kalua barra e provës ?
D1. Pasuria	Raporti i ILDKPKI-së konkludon: Deklarim i saktë, burime të ligjshme financiare, subjekti nuk ka kryer fshehje të pasurisë, s'ka bërë deklarin të rremë , subjekti nuk ndodhej ne kushtet e konfliktit të interesit.	Raporti nga ILDKPKI	Lidhur me gjykimin e kriterit të pasurisë, kontrollit të figurës, aftësive profesionale, relatorja e çështjes, pohoi se hetimi ishte bazuar në të dhënat e ardhura nga ILDKPKI, Inspektoriati i KLD, hetimi administrativ i KPK-së, të dhënat e marra nga institucionet publike dhe nga shpjegimet e bëra nga vetë subjekti i rivlerësimit. Në bazë të rezultateve të hetimit, subjekti të rivlerësimit i ishte kërkuar të japë shpjegime/prova.
	Shorti për subjektin e rivlerësimit ishte hedhur më 15.05.2018. Në lidhje me kriterin e pasurisë renditen: 1. Ap. Banimi 110m2. Vlera 72mijë lekë/m2 dhe totale 7 milion e 920 mijë lekë. Burimi i të ardhurave: Kredi në BKT në vlerën 6 milion 863 lekë, kredi në proces. Kursime nga shitja e një AP. Banimi në vitin 2012 në bashkëpronësi me prindërit e tij. Vlera e këtij apartamenti në total 55,000 euro, ndërsa pjesa takuese 18,000 euro. 2. Analiza financiare rezultoi: Subjekti ka pasur burime të mjaftueshme për të blerë apartamentin. Nga hetimi i bërë nga KPK ka rezultuar që apartamenti prej 77m2 është blerë në vitin 2006 nga babai i subjektit në vlerën 49,000 euro dhe si burim të ardhurash ka shërbyer puna e babait nga aktiviteti tregtar i shitjes me shumice dhe pakicë të mallrave. 3. Veturë Benz në bashkëpronësi me bashkëshorten. Blerë në vitin 2014, në vlerën 6,000 euro. Burimi i të ardhurave: Kursimet nga puna e bashkëshortes. 4. Automjet Pezho viti 2006, në pronësi 50% i bashkëshortes dhe 50% i babait të saj. Vlera: 4,000 euro. Burimi i të ardhurave: Kursimet e saj dhe të babait. 5. Analiza financiare e personave të lidhur me subjektin e rivlerësimit rezultoi pozitive. 6. KPK në hetimin e bërë nuk ka gjetur pasuri të padeklaruara apo të fshehura të subjektit të rivlerësimit apo të personave të lidhur me të.	Relatori i çështjes	
		Mbrojtja	
	Përfaqësuesi i ONM, z. Theo Jacobs ngriti dyshime lidhur me shumën e parave 18,000 euro (Pjesa takuese nga shitja e apartamentit në bashkëpronësi me prindërit e tij), para, të cilat nuk kanë qarkulluar përmes sistemit bankar. Pyetja e z. Jacobs lidhet pikërisht me faktin se ku kishin qëndruar këto para për rreth 4 vjet?	ONM	
		Ankesa nga publiku	
Z. Roshi lidhur me pyetjen e bërë nga përfaqësuesi i ONM u përgjigj me faktin se ka qenë dëshira e prindërve të tij që ti mbanin paratë në shtëpinë e tyre dhe jo në bankë. Ai komentoi edhe faktin që për blerjen e atij apartamenti nuk kishte kontribuar në vlerë monetare por ka qenë dëshira e prindërve të tij për ta përfshirë si bashkëpronar.	Subjekti		
	Raporti i DSIK konkludon: Përshtatshmërinë për vazhdimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit z. Eriol Roshi.	Të dhëna nga raportet e DSIK	

D2. Figura /Kontaktet me krimin e organizuar	zj. Sanxhaktari pohoi se nga KPK nuk ka pasur indicje të tjera për të vazhduar hetimin e mëtejshëm lidhur me kriterin e kontrollit të figurës.	Relatori	
		Mbrojtja	
		Subjekti	
	Pranë KPK janë regjistruar 3 denoncime lidhur me z. Roshi. Sipas zj. Sanxhaktari njëri prej këtyre denoncimeve është bërë mediatik në emisionin "BOOM". Subjektit të rivlerësimit lidhur me denoncimet i është kaluar barra e provës, ndërkohe po shqyrtohen nga KPK.	Ankesa nga publiku	
		ONM	
D3. Vlerësimi i aftësive profesionale dhe etikës	Raporti lidhur me aftësitë profesionale është bazuar në 3 dosje të zgjedhura nga vetë subjekti dhe 5 dosje të përzgjedhura rastësisht me short. Rezulton: Subjekti i rivlerësimit ka aftësi në interpretimin e ligjit, jep argumente të plota, vendimet janë të mirë arsyetuara, të qarta dhe të kuptueshme. Nuk ka deklarime negative mbi etikën e z. Roshi në punë.	Inspektoriat i Këshillit të Lartë të Drejtësisë	
	Z. Roshi ka ndërmarrë disa iniciativa për të përmirësuar funksionimin e gjykatës.	Relatori	
		ONM	
	Lidhur me denoncimet e ardhura pranë KPK-së, Z. Roshi pohoi se përveç denoncimit të bërë nga shtetasi me iniciale A.B, të tjerat janë në gjykim në Gjykatën e Apelit por pa dhënë detaje të mëtejshme.	Subjekti	
<b>E. Konkluzione dhe komente të monitoruesit të KSHH (Vlerësimi paraprak i monitoruesit të KSHH për aspektet e procesit të drejtë ligjor (publiciteti, etika e organeve të vettingut dhe përfaqësuesit të OMN , si e vlerësoni hetimin administrativ, të drejtat e mbrojtjes së subjektit, barazia e mjeteve ligjore, parimi i kontradiktoritit, koha e arsyeshme, e drejta për të paraqitur prova dhe e drejta për tu dëgjuar, etj.)</b>	Seanca dëgjimore për subjektin e rivlerësimit z. Eriol Roshi, Kryetar në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë, Tiranë zgjati 30 min., duke respektuar kriteret për një gjykim të drejtë dhe të paanshëm. Pati pyetje nga përfaqësuesi i ONM-së, kundërshtime nga subjekti i rivlerësimit. Relatorja e çështjes zj.Sanxhaktari pohoi qe janë respektuar procedurat për një proces të drejtë si:- subjekti i rivlerësimit ishte njoftuar mbi procedurën e rivlerësimit,- i ishte lënë 7 ditë kohë për tu njohur më dosjen, -ishte njohur me përbërjen e trupit gjykues,- i ishte kaluar barra e provës duke sjellë shpjegime e prova. -Subjekti nuk ka pasur konflikt interesi me asnjë nga anëtarët e trupit gjykues. Pranë KPK ishin regjistruar 3 denoncime lidhur me z. Roshi. Njëri prej këtyre denoncimeve ishte bërë mediatik, në emisionin "BOOM". Relatorja e çështjes nuk citoi natyrën e denoncimeve. Vetë Z. Roshi lidhur me denoncimet pohoi se përveç denoncimit të bërë nga shtetasi A.B , të tjerat janë në shqyrtim në Gjykatën e Apelit por pa cilësuar natyrën apo detaje rreth tyre. Nuk u konstatua asnjë shkelje, paragjykim apo presione të ndryshme gjatë seancës. . Përmasat e sallës në pallatin e Koncerteve (ish pallati i Kongreseve) garantuan respektimin e plotë të standardeve të një seance publike dhe akomodimin e të gjithë të pranishmëve.		